



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.07.2025
Numër Protokolli: 5046/2025

A.nr.951/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.951/2025, të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi B.S, kundër organit të punësimit: Komuna e Hanit të Elezit , në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.951/2025, e datës 23.05.2025, e parashtruar nga ankuesi B.S.

II. Anulohet Vendimi 02/Nr.3573/2025, i datës 19.05.2025, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit.

III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit, që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita re pranimit, duke ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për kthimin e mjeteve të ndaluara si rezultat i shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, dhe heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e palës ankuese.

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit, më datë 23.05.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3415/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.951/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi 02/Nr.3573/2025, i datës 19.05.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 25.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Hanit të Elezit, ndërsa kjo e fundit, më datë 02.07.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosijes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4533/2025 të datës 07.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 3415/2025, të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.1541/2024 të KPMSHCK-së; Vendimin 02/Nr.3573/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Përgjigjen në ankesë të datës 02.07.2025 nga Komuna e Hanit të Elezit; Akt Emërimit e datës 03.07.2024 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Arkivit dhe Transparencës datë 15.11.2021; Procesverbalin e datës 19.05.2025 të Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 14.05.2025 nga B.D për ASHI; Emailin e datës 15.05.2025 nga B.L-J për B.D; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin datë 24.02.2025; Përgjigjen në ankesë nga Komuna e Hanit të Elezit datës 08.11.2024; Komunikimet mes A.B dhe B.L-J të datës 03.06.2022, 12.07.2022, 12.09.2022, 06.01.2023, 02.07.2023, 23.03.2023, 18.07.2023, 08.08.2023, 12.02.2024; Emailin e datës 10.08.2024 nga N.K për ankuesin; Vendimin me numër 6744/2024 të datës 16.09.2024 të komisionit disiplinor; Procesverbalet e Komisionit Disiplinor datës 03.09.2024, 28.08.2024; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor 02Nr.6774/2024; Raportin për prezencës në punës për periudhën 01.03.2024 deri 31.07.2024; Ftesë për trajnim për Zyrtarët Arkivor të Komunave TË Kosovës; Vendimin A.nr.998/2023 të KPMSHCK-së; Raportin përfundimtar i performancës për vitin 2023 Komuna e Hanit të Elezit; Raportin mujor për muajin janar, shkurt 2024; Formularin i raportimit vjetor datës 30.01.2024; Raportin statistikor të lëndëve; Ftesë e datës 11.04.2024; Raporti mujor për muajin maj 2024; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 16.01.2023, 28.02.2024; Komunikimet përmes emailit mes ankuesit dhe N.K datë 04.07.2024, 13.12.2023, 31.07.2023, 28.07.2023, 18.05.2023, 17.05.2023, 02.08.2023; Procesverbalin e bordit të drejtorëve datës 03.08.2023, 11.08.2023; Komunikimet përmes emailit mes N.K dhe ankuesit datë 18.08.2023; Procesverbalin e bordit të drejtorëve datës 24.04.2023, 21.07.2023, 07.03.2023; Komunikimet përmes emailit mes ankuesit dhe N.K datës 20.02.2023, 13.1.2023, 18.05.2023, 25.10.2023, 05.05.2023, 06.06.2023; Vërejte me shkrim e datës 13.12.2023; Vendimin me numër 02/559/2011 për caktimin e zyrtarit përgjegjës për komunikim me qytetarë; Raportin e vlerësimit të transparencës në Komuna janar-dhjetor 2023; Raportin mujor për muajin prill 2024; Raporti i hyrje daljeve në punë për ankuesin datë 03.06.2024, 04.06.2024, 27.06.2024, 28.06.2024, 24.06.2024, 25.06.2024; Emailin e datës 21.06.2024 nga N.K për ankuesin; Raporti mujor për muajin korrik 2024; Procesverbal i bordit të drejtorëve i datës 29.04.2024; Raporti

mujor për muajin qershor, mars 2024; Procesverbal i bordit të drejtorëve i datës 10.06.2024; Emailin e datës 09.05.2024 nga A.B Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit datës 09.08.2024; Komunikimin me email mes ankuesit dhe N.K datë 30.07.2024; Vendimin A.nr.40/2024 i KPMSHCK-së; Kërkesën për anulim të vendimit e datës 20.12.2023 nga ankuesi për Drejtoreshën e Administratës; Përgjigjen në kërkesë d satës 05.10.2024 nga Drejtoresha e Administratës për ankuesin. Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër 5649/2024 të datës 03.07.2024, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar i Arkivit dhe Transparencës* pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, të Komunës së Hanit të Elezit.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedh se Drejtoresha e Administratës së Përgjithshme e Komunës së Hanit të Elezit, në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 09.08.2024, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit nën supozimet për shkelje të ndryshme disiplinore.

Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me datë 16.09.2024 ka nxjerrë Vendimin 02/Nr.6744/2024, mbi të cilin ka konstatuar se veprimet e ankuesit janë në kundërshtim me nenin 55, 56 dhe 57 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik si dhe nenin 4 dhe 16 të Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushime dhe Vijueshmërinë e Zyrarëve Publik, ashtu që të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore ndalim nga njëzet përqind (20%) e pagës për periudhën katër (4) mujore, si dhe sipas pikës II të këtij vendimi ka përcaktuar se ndalimi i pagës fillon nga muaji Tetor 2024 deri në muajin Janar 2025.

Ankuesi, kundër këtij vendimi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 07.04.2025 ka nxjerr Vendim A.nr.1541/2024 me të cilin ka aprovuar ankesën,. Ka anuluar vendimin e kontestuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, në procedurë të rishqyrtimit të rastit të ankuesit, më datë 19.05.2025 ka nxjerr Vendim 02/Nr.3573/2025, me të cilin ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *ndalim nga njëzet përqind (20%) e pagës për periudhën katër (4) mujore*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit 02/Nr.3573/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit, pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka mandat të konstatoj nëse vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë të pasafatshme, Nuk është zbatuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ngase është vendosur sikurse rastin e parë pa dhe komplet njëjtë.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, në procedurë të vendosjes në këtë çështje juridike administrative, ka konstatuar faktin se edhe ankuesi në pretendimin e tij në ankesën e datës 23.05.2025, pretendon se Komuna e Hanit të Elezit nga muaji tetor të vitit 2024 deri në muajin janar 2025 ka bërë ekzekutimin e Vendimit 02/Nr.6744/2024 të Komisionit Disiplinor dhe ka bërë ndalesën e pagës sipas këtij vendimi. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Komuna e Hanit të Elezit, me rastin e ekzekutimit të Vendimit 02/Nr.6744/2024 të Komisionit Disiplinor gjegjësisht

ndalesën e pagës së ankuesit, ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 144 paragraf 1 të të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës, e për rrjedhojë në rastin konkret, akti apo Vendimi 02/Nr.6744/2024 të Komisionit Disiplinor edhe përkundër faktit që në pikën II të diapozitivit të këtij vendimi është përshkruar: *Ndalimi i pagës si në nenin (1) të këtij vendimi fillon nga muaji tetor 2024 deri në muajin janar 31.01.2025*, i njëjti në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë është ekzekutuar respektivisht palës i janë ndaluar mjetet monetare sipas këtij vendimi sepse në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore si më lartë për ekzekutimin e vendimit, për me tepër që Komuna e Hanit të Elezit ka qenë e njoftuar se ka ankesë ndaj këtij vendimi dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi, ka qenë e obliguar që të pezulloj çdo veprim karshi këtij vendimi, ngase kjo është përcaktuar sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.**

Tutje, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit 02/Nr.3573/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit, dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Hanit të Elezit, përveç që më datë 14.05.2025 i është drejtuar Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit e përmes këtij emaili ka kërkuar vijueshmërinë e ankuesit, nuk ka ndërmarr ndonjë veprime tjetër procedural sipas udhëzimeve të dhëna si në Vendimin A.nr.1541/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjësisht nuk ka mbajtur senacë më palën ankuese dhe iniciuesin e procedurës disiplinore siç ka qenë e obliguar, rrjedhimisht tërë procedurën e ka zhvilluar mbi bazën e procesverbaleve paraprake, e kur dihet që procedura paraprake është anuluar, kështu që me anulimin e Vendimit 02/Nr.6744/2024 të Komisionit Disiplinor, janë anuluar të gjitha veprimet procedurale të Komisionit Disiplinor. Ndërlidhur me këtë vetë Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02/Nr.3573/2025, të datës 19.05.2025 në paragrafin e parë të arsytimit të këtij vendimi konstaton se ka bërë ndryshmet në këtë vendim sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e Këshillit, ndërsa pjesa tjetër e vendimit të komisionit disiplinor mbetet e njëjtë, rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse Vendimi 02/Nr.6744/2024 i Komisionit Disiplinor është anuluar në tërësi, si mund të mbeten në fuqi në procedurë të rishqyrtimit konstatimet e dhëna nga një vendim i anuluar.

Për më tepër, Komisioni Disiplinor i Komunës së Hanit të Elezit, në vend që të ndërmarr të gjitha verimet procedurale sipas obligimeve të dhëna si në Vendimin A.nr.1541/2024 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i njëjti është lëshuar në trajtimin e këtij vendimi duke konstatuar që i njëjti është i pasafatshëm, në këtë kontekst Kolegji i Këshillit, konstaton se ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shqyrtohet nga gjykata dhe palët të pakënaqura kanë të drejtë të iniciojnë konflikt admirativ sipas 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr për bazë së respektimi i vendimeve të organit me të lartë administrativ në këtë rast vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë vendime përfundimtare në procedurë administrative, dhe janë të detyrueshëm për organet tjera, në këtë rast Komisioni Disiplinor i Komunës së Hanit të Elezit në vendimin e kontestuar me ankesë, nuk

ka ndërmarr të gjitha veprimet sikurse janë dhënë sipas udhëzimeve si në Vendimin A.nr.1541/2024 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale të theksuara si më lartë, e bëjnë që Vendimi 02/Nr.3573/2025, i datës 19.05.2025, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit, të jetë akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin 02/Nr.3573/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Hanit të Elezit dhe të obligoj Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit, që në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për kthimin e mjeteve të ndaluara si rezultat i shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, dhe heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e palës ankuese.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.951/2025**

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit B.S;*
- *Komunës së Hanit të Elezit (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore) si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*